

KONTRATË SHITJE E KUOTAVE TË KAPITALIT

Sot më datë 12/10/2018, u hartua dhe nënshkrua kjo kontratë midis palëve të mëposhtme:

Z. Klodian SHEHI, i biri i Idriz dhe Sherife, shtetas shqiptar, i datëlindjes 28.03.1981, lindur në Durrës dhe banues në Rr. Sami Frashëri, pallati TID, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me leternjoftimin nr. personal I10328255P, këtu e më poshtë referuar si “**Shitësi**”,

dhe

Z. Shkëlqim HOXHA, i biri i Hamit dhe Mihane, shtetas shqiptar, i datëlindjes 10.05.1969, lindur në Kavajë dhe banues në Lundër, Rolling Hills, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga leternjoftimi me nr. personal G90510213G, këtu e më poshtë referuar si “**Blerësi**”

Të cilët shprehën vullnetin e tyre të lirë për të lidhur kontratën e mëposhtme. Palët e mësipërme ranë dakord për përbajtjen e kontratës ndërmjet tyre, si më poshtë vijon:

Preamble:

Duke qënë se Z. Klodian SHEHI dëshiron të shesë 45% të kuotave të kapitalit themeltar që ai zoteron në shoqërinë tregtare “Panto Resort” Sh.p.k, regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit me NIPT L01807001L;

Duke qënë se Z. Shkëlqim HOXHA dëshiron të blejë 45% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare “Panto Resort” Sh.p.k, që zoteron Z. Klodian SHEHI;

Duke qënë të vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, si dhe në përbushje të parashikimeve të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe Statutit të Shoqërisë Tregtare “Panto Resort” Sh.p.k, palët e mësipërme vendosin të lidhin këtë kontratë në përputhje me kushtet si më poshtë.

Neni 1 Kushtet e Kontratës

1.1 Në lidhjen e kësaj Kontrate ekziston pëlgimi i palëve në marrjen përsipër të detyrimeve përkatëse, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet, dhe objekti që formon lëndën e kontratës.

k.shehi

1.2. Kontrata quhet e vlefshme meqënëse palët kanë shfaqur dhe shprehur në mënyrë të ndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.

1.3. Në ketë Kontratë, palët shprehin dhe garantojnë që shkaku ligjor i lidhjes së saj nuk është i paligjshëm, nuk vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik si dhe Kontrata nuk shërben si mjet për të shmangur zbatimin e një norme të legjislacionit shqiptar.

Neni 2 **Qëllimi i Kontratës**

2.1 Qëllimi i kësaj Kontrate është transferimi i pronësisë kundrejt pagesës, të Kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare “*Panto Resort*” Sh.p.k, që zotëron Shitësi, në favor të Blerësit.

2.2. Kjo Kontratë shërben për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe mënyrave të transferimit të kësaj pronësie, si dhe pagesat përkatëse në lidhje me këtë transferim.

2.3. Me anë të këtij veprimi juridik të dyanshëm, palët synojnë të krijojnë një marrëdhënie juridike ndërmjet tyre, e cila mbështetet në parimet e ndërshmërisë, ligjshmërisë dhe besimit reciprok ndërmjet palëve.

2.4. Në përcaktimin e kushteve, Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përbajtjen e saj, dhe angazhohen të kryejnë veprimet e tyre brënda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi dhe nga përbajtja e kësaj kontrate.

Neni 3 **Objekti i Kontratës**

3.1. Objekti i kësaj Kontrate është i mundshëm, i ligjshëm, dhe i përcaktueshëm nga Palët nëpërmjet kësaj Kontrate, si dhe konsiston në Kuotat e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare “*Panto Resort*” Sh.p.k, kundrejt vlerës së shitjes së tyre.

3.2. Me anë të kësaj Kontrate, Shitësi detyrohet t'i japë dhe ti kalojë Blerësit 45 % të Kuotave të Kapitalit Themeltar që ai zotëron tek Shoqëria Tregtare “*Panto Resort*” Sh.p.k, kundrejt shpërblimit të caktuar në këtë Kontratë.

3.3. Blerësi merr përsipër t'i paguaj Shitësit shumën prej 4 500 000 (katër milion e pesëqind mijë) lekë në momentin e nënshkrimit të kontratës, kundrejt transferimit të pronesise së 45 % të Kuotave të Kapitalit Themeltar që ai zotëron në Shoqërinë “*Panto Resort*” Sh.p.k.

3.4. Si rezultat i kësaj Kontrate, Blerësi do të mund të ushtrojë të njëjtat të drejta në Shoqërinë “*Panto Resort*” Sh.p.k, për të cilat ishte titullar Shitësi.

K. Sheli

Neni 4
Efektet e Kontratës dhe Procedura për Shlyerjen e Detyrimit

4.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e pagesës së shumës 4 500 000 (katër milion e pesëqind mijë) lekë kur të nënshkruhet kjo kontratë.

4.2 Detyrimi në vlerën e përcaktuar më sipër, do të kryhet përmes transfertës bankare në llogarinë e Z. Klodian SHEHI.

4.3 Llogaria Bankare e Z. Klodian SHEHI, përfundimtari i përmbytjes së detyrimeve te kësaj Marrëveshje, do të jetë si më poshtë vijon:

Banka: - _____ sh.a.
Nr. i Llogarise: _____

4.4 Per shëmangjen e cdo keqkuptimi, permbushje e plote e detyrimeve te marrëveshjes do të konsiderohet konfirmimi nga ana e bankës e kalimit të pagesës ne llogari të Z. Klodian SHEHI

4.5. Kjo kontratë ka forcën e ligjit për palët kontraktuese.

4.6. Kontrata ka efekt ndaj të tretëve dhe subjekteve te tjera sipas parashikimeve te ligjit.

Neni 5
Zgjidhja e Kontratës

5.1. Në rastet kur njëra nga palët kontraktuese nuk përbush detyrimet e veta të parashikuara nga kjo Kontratë, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

5.2. Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në rast se pagesa nuk do të kryhen në afatin dhe në shumën e parashikuar më sipër. Në këtë rast kontrata zgjidhet kur pala e interesuar i deklaron palës tjetër se do të përdorë kushtin e zgjidhjes së kontratës.

Neni 6
Transferimi i të Drejtave

6.1. Asnjëra nga palët nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës, me përashtim të rastit kur jepet miratimi paraprak i palës tjetër.

Neni 7

K. Sheli



Interpretimi i Kontratës

7.1. Në rast se do të lindë e nevojshme të interpretohet kjo Kontratë, atëherë do të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës.

7.2. Kushtet e Kontratës do të interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit të Kontratës

7.3. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

Neni 8 Baza Ligjore

8.1. Kontrata hartohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

9.1. Blerësi dhe Shitësi angazhohen të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

9.2. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit ndërmjet tyre, problemet do të mundohen të vlerësohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legislacionit të Republikës së Shqipërisë.

9.3. Në rast të konflikteve gjyqësore, Gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10 Dispozita të fundit

10.1 Kjo marrëveshje është përpiluar në tre kopje, dhe pas nënshkrimit të saj nga palët secila prej tyre merr nga një kopje, një kopje depozitohet në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri.

Shitësi

Z. Klodian SHEHI
KLODIAN SHEHI
K. Shehi

Blerësi

Z. Shkëlqim Hoxha
Shkëlqim Hoxha
Hoxha